



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr. 131/3 prot.

Tiranë, më 29.01.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 09, datë 29.01.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA PËR
TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË NËPUNËSIT ARBËR GJONI, NË
INSTITUCIONIN E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE DHE
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të dokumentacionit të administruar në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, janë administruar informacionet sipas shkresave: nr. 1058 prot., datë 16.12.2025; nr. 131 prot., datë 20.1.2026 dhe nr. 131/1, datë 27.1.2026, të dërguara nga nëpunësi Arbër Gjoni, në përmbajtje të së cilave ngrihen pretendime, për transferim në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, të nëpunësit nga pozicioni i mëparshëm i punës

“Doganier”, Zyra e Operacioneve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë, kategoria e pagës IV-2, në pozicionin *“Doganier”*, Zyra e Regjimeve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Tiranë.

Në përmbajtje të informacionit të dërguar pranë Komisionerit, nëpunësi parashtroi se, ka filluar marrëdhënien e punës si punonjës i Doganave prej vitit 2012, duke u emëruar në pozicione të ndryshme të shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Rezulton se, me shkresën nr. 12936 prot., datë 4.8.2023, *“Për transferimin e nëpunësit për shkak të rristurimit”*, nëpunësi është emëruar në pozicionin *“Doganier”*, Zyra e Operacioneve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë, kategoria e pagës IV-2, ku ka vijuar të punojë deri në momentin e daljes së aktit të transferimit të përkohshëm nr. 12857 prot., datë 24.6.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Nëpunësi parashtroi se gjatë periudhës 24.6.2025 – 19.1.2026, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, janë ndërmarrë një sërë veprimesh administrative, të cilat kanë të bëjnë me transferime të përkohshme, të përsëritura të nëpunësit në pozicione të ndryshme, në degët përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për të cilat pretendon se, i janë cënuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të garantuara nga legjislacioni për nëpunësin civil.

Rezulton se, me urdhrin nr. 12857 prot., datë 24.6.2025, *“Mbi transferimin e përkohshëm në detyrë”*, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave e ka transferuar përkohësisht nëpunësin në pozicionin *“Doganier”*, Zyra Doganore e Hidrokarbureve, Sektori Doganor Porto Romano, Dega Doganore Durrës, kategoria IV-2.

Në vijim të marrëdhënies së punës në këtë pozicion, me shkresën nr. 15173 prot., datë 28.7.2025, nëpunësi ka kërkuar pezullimin nga shërbimi civil për arsye shëndetësore, për një periudhë dy mujore, nga data 1.8.2025, deri në datën 30.9.2025. Kjo kërkesë është miratuar me vendimin nr. 15173/1 prot., datë 30.7.2025, nga Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Pas përfundimit të periudhës së pezullimit, nëpunësi është rikthyer në detyrë në pozicionin ku ka qënë i transferuar përkohësisht, *“Doganier”*, Zyra Doganore e Hidrokarbureve, Sektori Doganor Porto Romano, Dega Doganore Durrës.

Në vijim, nëpunësi ka depozituar kërkesën nr. 24681 prot., datë 12.12.2025, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, duke kërkuar rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës *“Doganier”*, Zyra e Operacioneve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë, nisur nga fakti se, në datën 25.12.2025, përfundonte afati i

transferimit, si edhe nga gjendja e tij shëndetësore, e cila pamundësonte ushtrimin e funksioneve në Degën Doganore Durrës.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Zv/Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, me shkresën nr.24681/1 prot., datë 23.12.2025, i ka kërkuar nëpunësit të paraqesë raport mjekësor për vërtetimin e pamundësisë për të ushtruar detyrën në pozicionin e transferuar.

Të njëjtën kërkesë, për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, nëpunësi e ka paraqitur edhe pranë Komisionerit, duke kërkuar verifikimin e ligjshmërisë së akteve administrative të nxjerra nga titullari i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe rikthimin e ligjshmërisë, duke vendosur kthimin në pozicionin ku ka emërimin e rregullt në shërbimin civil (*shkresa e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1058 prot., datë 16.12.2025*).

Bazuar në pikën 1, të nenit 14, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pas analizës së përmbajtjes së informacionit dhe dokumentacionit shoqërues, Komisioneri, me shkresën nr.1058/1 prot., datë 30.12.2025, ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në kushtet e përfundimit të afatit të transferimit, që nëpunësi të kthehej në pozicionin e mëparshëm të punës, mbështetur në përcaktimet e pikës 7/c, të nenit 15, të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke përcaktuar detyrimin e institucionit për të informuar Komisionierin, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, brenda afatit 10 ditor.

Në përgjigje të kërkesës, institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, me shkresën nr.25793/1 prot., datë 15.1.2026, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 134 prot., datë 20.1.2026, ka informuar se, me urdhrin nr. 917 prot., datë 15.1.2026, “Për rikthim në detyrë”, të titullarit të institucionit, nëpunësi Arbër Gjoni është rikthyer në detyrën e mëparshme “Doganier”, Zyra e Operacioneve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë, pozicion në të cilin ka emërimin e rregullt në shërbimin civil.

Ndërkohë, rezulton se, në të njëjtën ditë që merr njoftimin për rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, me urdhrin nr. 1005 prot., datë 19.1.2026, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, “Mbi transferimin e përkohshëm në detyrë”, nëpunësi është transferuar përsëri në pozicionin “Doganier”, Zyra e Operacioneve të Hidrokarbureve, Sektori Doganor Porto Romano, Dega Doganore Durrës.

Pra, institucioni e ka rikthyer ligjshmërinë dhe menjëherë, pas këtij veprimi, e ka dërguar nëpunësin përsëri në të njëjtin pozicion ku ka qënë i transferuar përpara ndërhyrjes së Komisionerit.

Më tej, sipas informacioneve të dërguara pranë Komisionerit dhe akteve administrative të administruara, evidentojmë faktin se, vetëm disa ditë më vonë, me urdhrin nr. 1574 prot., datë 26.1.2026, “Mbi transferimin e përkohshëm në detyrë”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, nëpunësi transferohet në pozicionin “*Doganier*”, Zyra e Regjimeve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, në Degën Doganore Tiranë.

Referuar sa u analizua më sipër, konstatohet se, për një periudhë 7-mujore, nëpunësi është transferuar tre herë radhazi, në pozicione të ndryshme të punës, nga titullari i institucionit, e për më tepër duke mos marrë në konsideratë faktin se, nëpunësi ka probleme shëndetësore për të ushtruar detyrën në pozicione pune të caktuara, fakt i provuar nga institucionet mjekësore, (*bashkëlidhur vërtetimi i mjekut të familjes në kërkesën për pezullim*).

Për këtë arsye, nëpunësi i është drejtuar përsëri Komisionerit me shkresën nr. 131/1 prot., datë 27.1.2026, duke kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera në këtë rast.

Në kuadër të hetimit administrativ dhe analizës së akteve, Komisioneri evidenton që në fillim faktin se veprimet e mësipërme të administratës doganore, janë kryer duke u bazuar në Kodin Doganor, i cili për shkak të veçantive dhe kompleksitetit të shërbimit doganor, (*pika 3, e nenit 13, të Kodit Doganor*), parashikon rregulla të posaçme, si në drejtim të llojeve të transferimeve, periodicitetit të tyre ashtu dhe të organit kompetent që urdhëron këto transferime.

Konkretisht, pika 7, e nenit 15, të këtij kodi, në gjurmën a) parashikon: “*Punonjësi doganor mund të transferohet, përkohësisht, në një pozicion tjetër të administratës doganore, të së njëjtës kategori, apo në një kategori më të lartë, **për këto arsye dhe kohëzgjatje:***”

- i) në interes të institucionit, deri në 6 muaj;
- ii) për përmirësimin e rezultateve të vetë nëpunësit, deri në 3 muaj;
- iii) për arsye të përkohshme shëndetësore apo gjatë shtatzanisë, në bazë të vendimit të komisionit kompetent, sipas ligjit, për sa është e nevojshme, sipas vendimit të komisionit përkatës.

Nga analiza e përmbajtjes së kësaj dispozite, evidentohet se është rregulluar vetëm një pjesë e institutit të transferimit që ka lidhje me a) arsyet e transferimit dhe b) me kohëzgjatja e transferimit, por nuk është parashikuar afati kohor brenda të cilit duhet të kufizohet transferimi i përkohshëm. Për të plotësuar këtë element të domosdoshëm për administrimin e shërbimit civil në përputhje me ligjin, gjatë aplikimit të institutit të transferimit të përkohshëm, organi që nxjerr aktin e transferimit, duhet ti referohet ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili në nenin 48, pika 1/a, parashikon se transferimi i

përkohshëm i një nëpunësi lejohet jo më shumë se për një periudhë 6-mujore, **gjatë dy viteve**.

Nevoja për kufizimin e transferimit të përkohshëm brenda një periudhe të caktuar kohore, lind nga njëra anë si domosdoshmëri për të krijuar një shërbim civil të qëndrueshëm dhe nga ana tjetër, për të siguruar: a)shmangien e arbitraritetit të drejtuesve ndaj punonjësve të administratës doganore dhe b)respektimin e parimeve të administrimit të shërbimit civil, ndër të cilat:

*“Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizimit dhe paanësisë politike, **si dhe qaranton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil**”.*

Referuar sa më lart, nxjerrja e akteve të njëpasnjëshme të transferimit të përkohshëm të nëpunësit, në 3 pozicione të ndryshme pune, brenda një periudhe 7 mujore, si dhe të pa argumentuara për domosdoshmërinë e tyre, shkel rëndë **parimin e qëndrueshmërisë në detyrë të nëpunësit civil** dhe bëhet shkak për arbitraritet në zbatimin e ligjit, e njëkohësisht e vendos punonjësin në presion negativ të përhershëm dhe të panevojshëm, ç`ka ndikon negativisht në realizimin me cilësi të detyrave të tij.

Ky përfundim bazohet edhe në përgjithësimin e praktikës gjyqësore në rastin e transferimit të nëpunësve të Administratës Doganore, ku është argumentuar se: **Në përfundim të afatit 6 mujor të transferimit të përkohshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave mund të transferojë një punonjës të administratës doganore për një afat tjetër apo më përsëritje, vetëm në kushtet e ekzistencës së nevojës së domosdoshme institucionale të argumentuar dhe duke përcaktuar saktë afatet e transferimit.**

Në rastin konkret, nisur nga analiza e përmbajtjes së akteve të transferimit, rezulton se në asnjë rast nuk është argumentuar arsyeja e transferimit të vazhdueshëm të nëpunësit, e po kështu, nuk është respektuar afati 2 vjeçar brenda të cilit duhet të kryhet transferimi deri në 6 muaj.

Kjo mangësi vlerësohet si një element paligjshmërie i aktit të transferimit, pasi si rregull në akt duhet të përcaktohet në mënyrë të shprehur koha e transferimit të përkohshëm dhe data e kthimit të nëpunësit në pozicionin e mëparshëm, duke respektuar kriteret që analizuam më sipër, gjë e cila do të siguronte një stabilitet në marrëdhënien e punësimit në shërbimin civil dhe transparencën e nevojshme, duke i siguruar nëpunësit mundësinë që të kërkojë konkretisht rivendosjen e të drejtës së tij.

Shkelja e mësipërme e kryer në hartimin e aktit të transferimit të përkohshëm objekt i vendimi, ka krijuar kushte për mosrespektimin e pikës 7/c, të nenit 15, të Kodit Doganor, ku përcaktohet në mënyrë të shprehur: *“Në përfundim të afatit të transferimit, nëpunësi kthehet në pozicionin e mëparshëm, me përjashtim të rasteve kur nëpunësi pranon të vijojë në pozicionin ku ishte transferuar”*, e po kështu edhe të nenit 48, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, ku parashikohet afati 2 vjeçar brenda të cilit mund të transferohet përkohësisht nëpunësi për një periudhë 6 mujore.

Në kushtet kur vërtetohet që afati 6 mujor i transferimit të nëpunësit Arbër Gjoni ka përfunduar dhe tashmë është tejkaluar, si dhe kur nuk kemi të bëjmë me ndonjë rast përjashtimor të parashikuar në ligj, ky punonjës duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; të neneve 109 dhe 114 ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar; si dhe në mbështetje të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Të kërkoj nga organi publik, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të nxjerrë aktin përkatës administrativ, për kthimin e nëpunësit Arbër Gjoni, në pozicionin e punës *“Doganier”*, Zyra e Operacioneve Doganore, Sektori i Operacioneve Doganore, Dega Doganore Tiranë, pozicion në të cilin ai ka emërimin e rregullt, për shkak se është plotësuar afati maksimal 6-mujor i transferimit, brenda 2 viteve, i parashikuar në germën a), pika 7, të nenit 15, të ligjit nr.102/2014, *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar dhe nenin 48, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.

3. Me kalimin e këtij afati, institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Ministria e Financave, Departamenti i Administratës Publike, si dhe nëpunësi Arbër Gjoni.
5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)